



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.484/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë për shkak të shkeljeve në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Anr.484/2025, Anr.494 te datës 09.02.2025

II Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2,000.00€ (dymijë) euro.

III. Detyrohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP ka pranuar ankesat Anr.484/2025 dhe 494/2025 ushtruar nga subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Në ankesën Anr. 484/2025 pretendohet se LDK Dega ne Prishtine ka verejtur se me rastin e vendosjes se postimit te mbeshtetësit te LVV Burim Mehmeti ne rrjetin social facebook

është shkelur neni 37 paragrafi 1, nenparagrafi 1.2 i LZP-se dhe neni 8, paragrafi 1, nenparagrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkëngjitur fotografinë që dëshmon për shkeljen e tillë në ditën e zgjedhjeve.

Në ankesën Anr.494/2025 pretendohet se Më datë 09 shkurt 2025, në ora 07:29/h, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Burim Mehmeti ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, me tekstin përshkrues "Grate e Kosovës janë forca dhe zemra e këtij vendi. Kësaj here do jeni edhe zemra e Prishtinës në Kuvendin e Republikës", duke i bashkëngjitur këtij postimi edhe fotografi të kandidaturës së deputetëve nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i cili ka bërë fushatë përmes thirrjes për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje.Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur Postimi i publikuar nga z. Burim Mehmeti, në rrjetin social Facebook.

PZAP iu drejtua me kërkesa për përgjigje subjektit politik LVV, i njëjti subjekt lidhur me ankesën Anr.484/2025 nuk ka dhënë ndonjë përgjigje ndërsa lidhur me ankesën Anr.494/2025 në përgjigje ka theksuar si Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlikonin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Për më shumë, z. Mehmeti i cili nuk ka ndonjë funksion në strukturat e LVV, në postimin e tij, ka bërë thirrje për gratë që të shfrytëzojnë të drejtën e votës. Kjo thirrje ka të bëjë me pjesëmarrjen e grave në demokraci, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.484/2025, Anr.494/2025, të datës; 09.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.484/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

- Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i fotografive në rrjetin social facebook, nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, z.Burim Mehmeti, dhe është vërtetuar se ka bërë postime në ditën e zgjedhjeve, duke shkelur dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), konkretisht neni 37 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i cili përcakton se "1.Nga hapja e qendrave të votimit për votim e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre iu ndalohet secili prej veprimeve: 1..... 1.2 bërja e fushatës në çfarëdo mënyre" Përveç kësaj, me nenin 8 par

paragrafi 1, nënpar. 1.5 Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, është përcaktuar “*Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprime par 1.5 shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjetave sociale me qëllim të ndikimit të votuesit*”, andaj PZAP vlerëson se mbështetësit e subjektit politik LVV kanë shkelur dispozitat e sipërcituara duke bërë fushatë në rrjetin social në facebook në ditën e zgjedhjeve, për votimin e kandidatëve nga radha e subjektit politik LVV.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor në fuqi lidhur me ndalesat e subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre nga hapja e qendrave të votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik në fjalë-LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, e sidomos në ditën e votimit. Andaj shpërndarja e fotografisë në rrjetin social facebook nga mbështetësi i subjektit politik të lartcekur, në ditën e zgjedhjeve për fushatë zgjedhore, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 37 par. 1, nënpar. 1.2 të LZP-së si dhe me nenin 8, par. 1 nënpar. 1.5 i Regullës Zgjedhore 07/2024.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet e subjektit politik LVV, të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje i njëjti e mohon shkeljen e bërë duke pretenduar se z. *Mehmeti nuk ka ndonjë funksion në strukturat e LVV, dhe në postimin e tij ka bërë thirrje për gratë që të shfrytëzojnë të drejtën e votes dhe kjo thirrje ka të bëjë me pjesëmarrjen e grave në demokraci në përputhje me legjislacionin në fuqi*, e të cilat pretendime i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se me këtë postim është shkelur heshtja zgjedhore gjatë ditës së votimit, pasi që është bërë thirrje për votimin e kandidateve femra të cilat kandidojnë për subjektin politik LVV, andaj dhe nga të gjitha këto arsye Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par. 1 dhe neni 120 par. 1 nënpar. 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.484/2025 më datën 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.